Kronikë

# ‘Më qëlluan me armë’, policia shpall në kërkim dy adoleshentë në Krujë pas denoncimit të 27-vjeçarit

*27-vjeçari tha se drejt tij qëlluan me armë një 17-vjeçar dhe një 18-vjeçar. Fatmirësisht nuk pati të lënduar apo dëme materiale nga ngjarja.*




*Foto ilustruese*




Redaksia
3 Shtator, 14:09 | **Përditesimi: 3 Shtator, 14:12**

Share

Dy adoleshentë në Krujë, të cilët dyshohet se kanë qëlluar me armë në drejtim të një 27-vjeçari, janë shpallur në kërkim nga policia.

Ka qenë vetë 27-vjeçari, i cili kallëzoi në Policinë e Krujës se një 17-vjeçar dhe një 18-vjeçar qëlluan me armë zjarri në drejtim të tij pas një sherri.

Por fatmirësisht nuk pati të dëmtuar nga kjo ngjarje.



LEXO EDHE:
**Tjetër rast denoncimi në Shkodër, 57-vjeçari kallëzon në polici: Në 2011, një person përdori të dhënat e mia për t'u pajisur me dokumente identifikimi**

Ndërkohë që dy adoleshentët janë shpallur në kërkim nga uniformat blu. Grupi hetimor po punon për të verifikuar dhe zbardhur këtë ngjarje, si dhe pretendimin e 27-vjeçarit që bëri kallëzim.

**Njoftimi i Policisë:**

> *Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë shpallën në kërkim 2 shtetas të moshave 17 vjeç dhe 18 vjeç, pasi ka kallëzuar një 27-vjeçar, se për motive të dobëta, kanë qëlluar në drejtim të tij, me armë zjarri, por pa shkaktuar dëmtime. Punohet për kapjen e 2 shtetasve, si dhe për verifikimin e kallëzimit dhe rrethanave të tjera të faktit.*

V.GJ /Shqiptarja.com

TAG: krujë policia te shtena me arme

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 4 Shtator, 18:18

**A jeni dakord me propozimin e Ramës për heqjen e depozitave të ujit nga pallatet?**

Po | Jo | Nuk kam mendim

## Lajme të tjera



Krujë/ Kultivuan 50 bimë kanabis, shpallet në kërkim 62-vjeçari dhe vihet nën hetim babai i tij! Në pranga një 66-vjeçar
2 Shtator, 13:54



Krujë/ Kishin kultivuar kanabis në fshatin Larushk, 2 në pranga dhe një në kërkim (EMRAT)
30 Gusht, 14:49



Krujë/ Zjarr në një kanal me mbeturina e shkurre në Nikël, në rrezik banesat dhe një kabinë elektrike, dyshohet i qëllimshëm
29 Gusht, 21:55



Zjarri përpin pyjet e Krujës, ndërhyn edhe helikopteri nga ajri për shuarjen! Dyshohet se shkaktohet qëllimisht nga guroret (VIDEO)
29 Gusht, 12:54



Dogji ullishtet e fqinjëve pas konflikteve për motive pronësie, arrestohet 19-vjeçari në Krujë! Rezultoi se ishte në arrest shtëpiak për drogë
13 Gusht, 09:27



Disa vatra zjarri në malësinë e Krujës, era favorizon flakët, problematike situata në Nikël e Barkanesh! Vetëm zjarrfikësit në aksion (VIDEO)
11 Gusht, 17:45



SHBA/ 17-vjeçari qëllon me armë në Times Square të Nju Jorkut, 3 të plagosur
9 Gusht, 16:16



U kap ‘mat’ duke u kujdesur për bimët narkotike, vihet në pranga 32-vjeçari në Krujë (EMRI+VIDEO)
9 Gusht, 10:29



Kërcënonte me kallashnikov familjarët, arrestohet 41-vjeçari në Krujë. Në banesë i gjenden 3 armë (EMRI)
6 Gusht, 12:39



Sherr për parakalimin, qëllohet me armë makina në autostradën Durrës-Tiranë, shpallen në kërkim 2 vëllezërit (EMRAT)
4 Gusht, 11:46




U konfliktua fizikisht me një person, AMP arreston efektivin e policisë në Dibër (EMRI)
3 Gusht, 10:50



Shkodër/ Të shtëna në bjeshkët e Munellës! 37-vjeçari: Kemi konflikt me një bashkëfshatar, gjeta tabelë me mbishkrimin ‘Ik se do vdesësh’! Policia gjen 6 gëzhoja
3 Gusht, 10:19



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje